

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kur u njoha me të, ishte në burg"/ Rrëfimi i gruas së Jakup Krasniqit: I kam bërë këtë premtim!
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/kur-u-njoha-me-te-ishte-ne-burg-rrrefimi-i-gruas-se-jakup-krasniqit-i-kam--i104679
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:23:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dc8d0f1b984b13be915517194e4c0a0c82b8bd458b1c830e0260975396c08b25
TEKSTI	99308de16b282268751004246ae2a21bfc4d78c9006d83ca6545be374f5aeed4
PAMJA	d27b923219cad19eab390cf00faf82b2e665db0b4aa3c5aefdd63471f795141b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2733d51df582d1095b993005f531eceec8edde3114aa7b9d8250229847224c15
E MËPARSHMJA	941e0775cdfca4437ea5f24b49a44bb03ab89d8119c330e8ecc702983bf7375
RRËNJJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2733d51df582d1095b993005f531eceec8edde3114aa7b9d8250229847224c15>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)




Flash: **dytë e Ballukut** një vile në kompleksin &ldq... ■ **Vesent tregon momentet** një jetë sociale pas vendimit ■ **protestës së zhvilluar sot pran&eum...** ■ **prerrektures italiane, kërkoinë 3** një rast që përfshin kompaninë ■ **me komet për probleme** Cristian Chivu për superpërballjen e

KOSOVA

“Kur u njoha me të, ishte në burg”/ Rrëfimi i gruas së Jakup Krasniqit: I kam bërë këtë premtim!

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 18:10



Pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së, bashkëshortja e Jakup Krasniqit, Sevdije Krasniqi, thotë se familja kishte shpresuar deri në fund për një vendim pafajësie.

“Ne kishim shpresë se do të shpallëshin të gjithë të pafajshëm. Vendimin e kemi pritur në shtëpi. Momenti i vendimit ishte shokues, nuk e prisnim. Kush janë ata 4 persona që po dënohen? Ata janë krerët e UÇK-së. Historia nuk do të helmohet nga asnjë vendim. UÇK-ja ka luftuar për liri. Ky vendim as nuk ndikon dhe as nuk duhet të ndikojë në jetën e Kosovës”, tha ajo në një intervistë për Top Channel.

Sevdije Krasniqi thotë se familja do të vijojë të presë procesin e Apelit dhe kërkon lirinë e të dënuarve. “Ne kërkojmë lirinë e tyre, do të presim Apelin. Besoj se tani do të bazohen në fakte. Tani dihet që ndërmarrja e përbashkët kriminale është udhëheqja e Serbisë bashkë me gjyqtarët e Gjykatës Speciale që dhanë këtë vendim”, u shpreh ajo.

Duke folur për marrëdhënien me Jakup Krasniqin, ajo tregon edhe si u njohën dhe si nisi historia e tyre e dashurisë.

“Ma propozoi një shoqe e ime dhe më tha: ‘Ja vlen ta presësh profesor Jakupin’. Unë e prita dhe, pasi doli, ne u bëmë bashkë. I kam thënë Jakupit që nuk të kam ardhur në burg atëherë, por në Hagë do të të vij çdo muaj...”, tregon ajo.

Për bashkëshorten e tij, më e vështira ka qenë mungesa e Jakup Krasniqit në momentet e rëndësishme familjare.

“E kam përjetuar shumë rëndë kur kemi pasur gëzime në shtëpi, që ai nuk ka mundur t’i përjetojë”, shprehet ajo.

Sevdije Krasniqi tregon se familja e priste kthimin e tij dhe se bashkë kishin bërë plane për jetën pas Hagës.

“Ne e prisnim në shtëpi, kishim bërë plane. Madje, me Jakupin kishim thënë që do të iknim të dy të jetonim në një shtëpi në fshat”, pohoi e shoqja e ish-kreut të UÇK-së.

Ajo tregon se Jakup Krasniqi kishte shprehur dyshime për procesin, duke iu referuar mënyrës së arrestimit të tij.

“Duke parë si rrodhën gjërat, tha: ‘Nuk besoj shumë, sepse është gjykatë raciste’, nga mënyra si na kanë arrestuar, kur vetë ai ka mundur të dorëzohet. Pra, një arrestim si në kohën e ish-Jugosllavisë, madje edhe më rëndë”, tha ajo.

Pas vendimit, familja kërkon që të shfrytëzohen të gjitha mundësitë ligjore dhe shpreson te Apeli.

“Ne kërkojmë që të përdoren të gjitha mjetet ligjore për zhbërjen e kësaj gjykate. Ne po shpresojmë në Apel. Kjo gjykatë nuk duhet të ketë më të drejtë të merret me luftëtarët tanë. Ne kemi përballuar gjenocid”, u shpreh ajo.

Në fund, Sevdije Krasniqi tregon edhe mesazhin që i përcjell bashkëshortit të saj në këtë periudhë të vështirë.

“Unë Jakupit i them të qëndrojë i fortë, ashtu siç ai është”, tha ajo

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 17 Shtator17:21

[Anita Haradinaj emocionohet teksa kujton periudhen kur Ramushi ishte ne Hage: E di dhimbjen, shtatzene kam qene](#)

Anita Haradinaj është rikthyer pas në kohë për të kujtuar një prej momenteve më të rëndësishme dhe emocio...

KOSOVA 17 Shtator17:01

[Diaspora shqiptare mblidhet në Times Square në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, prefekti i Tiranës ndan pamjet](#)

Pas shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë nga Dhomat e Specializuara në Hagë, me të cilin ish-krerët e Ushtr...

KOSOVA 17 Shtator15:40

["Nën hijen e flamurit"/ Gruaja e Rexhep Selimit reagon pas vendimit të Hagës](#)

Një ditë pas shpalljes së aktgjykimit nga Dhomat e Specializuara në Hagë, ka reaguar publikisht Shqipe Mehmeti-Selimi, bashkëshort...

KOSOVA 17 Shtator15:31

["Kundërshtojmë Gjykatën Speciale"/ Tjetër protestë në Prishtinë, Veteranët e UÇK-së paralajmërojnë: Qëndrimi ynë nuk ndryshon](#)

Protesta do të mbahet në sheshin "Skënderbeu", njoftimin e bëri të ditur Gazmend Sula gjatë një konference p&eu...

KOSOVA 17 Shtator15:04

[Mbështetën ish-krerët e UÇK-së, mediat serbe 'sulmojnë' Granit Xhakën, Dua Lipën dhe Rita Orën](#)

Qëndrimet e disa prej figurave shqiptare me njohje ndërkombëtare pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë kanë m...

KOSOVA 17 Shtator14:55

[Gjykata fajësoi Thaçin, por dokumenti i vitit 2000 sfidon versionin e Hagës për Behajdin Allaqin: Gruaja e tij tha se e mori policia serbe](#)

Një dokument hetimor i vitit 2000 po rikthen në qendër të vëmendjes rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit, një prej rasteve...

KOSOVA 17 Shtator14:31

[Haga dënoi me 81 vite burg ish-krerët e UÇK-së/ Studentët në Prishtinë nisin protestat: MARRE!](#)

Dhjetëra studentë janë grumbulluar në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë ditën e sotme, ndërsa po prot...

KOSOVA 17 Shtator10:07

["Me kokën lart babë, gjithmonë!"/ Djali i Jakup Krasniqit me mesazh një ditë pas vendimit](#)

Pas aktgjykimit ndaj ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, djali i tij, Altin Krasniqi, ka reaguar përmes një mesazhi...

KOSOVA 17 Shtator09:07

[Kreu i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve: Aktgjykimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj](#)

Aktgjykimi ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pritet të përballlet me një proces t&eu...

KOSOVA 16 Shtator23:01

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Zv.kryeministri shqiptar i Malit të Zi: Vendim i padrejtë, procesi nuk ka përfunduar](#)

Zv.kryeministri shqiptar i Malit të Zi, Nik Gjelošhaj, ka reaguar pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hag&eu...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...](#)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[VIDEO- Dy aksidente me pesë viktime/ Prezantues...](#)

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetarë televi...

LIFESTYLE 16 Shtator

[Prishtinë/ Shqiptarët protestojnë kundër vendim...](#)

Ndërkohë që në rrugët e Prishtinës po zhvillohen protesta e tubime lidhur me vendimin e Gjykatës Speciale të Hagës ...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59


[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues](#)

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pranë...

video




E premtë | ? 20:45 | Syri TV







E premtë | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premtë | ? 20:45 | ??? Syri TV





Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.